



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 104 / Prot. 1

Tiranë, më 26.01.2026

VENDIM

Nr. 12, Datë 15.01.2026

“PËR CAKTIMIN E PËRKOHSHËM TË PROKURORIT PRANVERA PUSTINA NË POZICIONIN E PROKURORIT NË PROKURORINË E PËRGJITHSHME”

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar
5. Arta MANDRO	Anëtar
6. Ledina RIZA	Anëtar
7. Moisi DUDA	Anëtar
8. Vatë STAKA	Anëtar
9. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.01.2026, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 18 e vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Për caktimin e përkohshëm të prokurorit Pranvera Pustina në pozicionin e prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme”

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 104 prot., datë 09.01.2026, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dëgjoi Relatorin, z. Sokol Stojani, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim Këshilli) është institucioni që garanton pavarësinë, disiplinën dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.
2. Me Vendimin nr. 06, datë 20.01.2020, "Për komandimin e magjistratit", Këshilli ka vendosur komandimin e prokurorit Pranvera Pustina, në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Prokurorinë e Përgjithshme. Afati komandimit filloi nga data 20.01.2020 me një kohëzgjatje prej 5 (pesë) vitesh.
3. Me Shkresën nr. 2392 prot., datë 16.10.2024, Prokurori i Përgjithshëm i është drejtuar Këshillit me kërkesë për ripërsëritjen e komandimit të prokurorit Pranvera Pustina në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Prokurorinë e Përgjithshme, për një mandat tjetër 5 (pesë) vjeçar me arsyetimin se, në disa drejtori e sektorë të Prokurorisë së Përgjithshme janë krijuar vakanca nga procesi i rivlerësimit kalimtar duke sjellë një ngarkesë pune të theksuar.
4. Në nenin 53, pika 10, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, parashikohet se:
"Magjistratit të komanduar i bëhet vlerësimi etik dhe profesional nga institucioni në të cilin magjistrati është komanduar, në përputhje me kriteret dhe procedurën që zbatohet për anëtarët e tjerë të këtij institucioni, me përjashtim të rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe. Nivelet e këtij vlerësimi njihen si nivele vlerësimi në kuptim të këtij ligji."
5. Bazuar në nenet 53, pika 10 dhe 56, pikat 2 dhe 3, të Ligjit nr. 96/2016 "Për Statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, me Shkresën nr. 2392/1 prot., datë 25.10.2024, Këshilli i ka kërkuar Prokurorit të Përgjithshëm, dërgimin e vlerësimit etik dhe profesional për magjistraten Pranvera Pustina.

Nga ana e zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm nuk është dërguar ende vlerësimi etik dhe profesional për magjistraten në fjalë.
6. Në kushtet e mësipërme, me qëllim trajtimin e kërkesës së Prokurorit të Përgjithshëm, Komisioni vlerësoi si të përshtatshëm, zbatimin e instrumentit të caktimit të përkohshëm për prokuroren Pranvera Pustina deri në dërgimin e vlerësimit etik dhe profesional nga ana e zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm.
7. Neni 59, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, parashikon se:
"1. Pozicioni i magjistratit mund të plotësohet përkohësisht, kur magjistrati me pozicion të përhershëm nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin për një periudhë jo më shumë se tre muaj, për shkak të:

a) caktimit në pozicione të tjera;

b) arsyeve të tjera të parashikuara nga ligji.

8. Lidhur me kriteret për caktimin e përkohshëm, në nenin 3, të Vendimit të Këshillit nr. 64, datë 15.04.2019, Rregullore “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve”, i ndryshuar, parashikon se, prokurori mund të caktohet përkohësisht në çdo pozicion të të njëjtit nivel ose të një niveli tjetër, për të cilin përmbush kërkesat dhe kriteret e parashikuara në ligj për këtë nivel apo pozicion, në të njëjtën prokurori ku ushtron funksionin ose në një prokurori tjetër. Këshilli respekton për aq sa është e mundur vullnetin e prokurorëve gjatë caktimit të përkohshëm.

Gjatë procedurës së përzgjedhjes së prokurorit për caktimin në një pozicion të përkohshëm, Këshilli mban parasysh:

a. përvojën dhe fushën e specializimit të prokurorit;

b. balancimin e nevojave të prokurorisë ku prokurori ushtron funksionin dhe prokurorisë ku ai do caktohet përkohësisht.

c. disponueshmërinë e prokurorit.

9. Duke ruajtur frymën e ligjit, me qëllim garantimin e funksionalitetit të zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm dhe rëndësinë e përmbushjes së detyrave funksionale të këtij institucioni, si dhe duke patur parasysh se, kushtet dhe rrethanat faktike mbi bazën e të cilave është vendosur komandimi i mëparshëm i prokurorit Pranvera Pustina në Prokurorinë e Përgjithshme nuk kanë ndryshuar, Komisioni e vlerësoi të përshtatshme vijimin e caktimit të përkohshëm të prokurorit në fjalë në këtë pozicion.

10. Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore dhe nënligjore, Komisioni pasi bëri verifikimet përkatëse për plotësimin e kushteve ligjore, përmes Relacionit përkatës i propozoi Këshillit, që prokurori Pranvera Pustina, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë të caktohet përkohësisht në pozicionin e prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme, për një afat deri në tre muaj duke nisur nga data 20.01.2026.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “e”, të Kushtetutës, në nenet 53 dhe 59, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenet 164, pika 8, 166, pika 2, 189 pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, dhe në nenin 3, të Vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë me nr. 64, datë 15.04.2019, Rregullore “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Prokurori Pranvera Pustina, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë të caktohet përkohësisht në pozicionin e prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme.
2. Prokurori Pranvera Pustina do të ushtrojë detyrën si prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme për një afat deri në tre muaj, duke nisur nga data 20.01.2026.
3. Të njoftohen për këtë vendim Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe prokurori Pranvera Pustina.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë sot më 15.01.2026.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Erind Merkuri

ZV/KRYETAR
Erind Gërmenji

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Erion Fejzulla